



In medias res

Megjithatë, Kosova po lëvizë përpara!

*“Kujdesi për jetën njerëzore, lumturinë, dhe mos shkatërrimin tyre, është i pari dhe vetmi qëllim i qeverisjes së mirë”
Th. Jefferson, 1743 -1826, Presidenti i tretë i SHBA-ve*

Kosova është në një udhëkryq të madh historik. Puna që bëjmë sot, përcakton të ardhmen e gjeneratave që vijnë më pas. Sot krijohet themeli mbi të cilën duhet të ndërtohet jeta, begatia, mirëqenia, dhe lumturia e fëmijëve tanë. Për të ndërtuar këtë themel të fortë dhe të qëndrueshëm, nevojitet një qeverisje e mirë dhe efikase, një vend ku sundon ligji dhe shteti ligjor, ku drejtësia dhe barazia janë të pa cenueshme, ku *“...asnjeri nuk është mbi ligjin edhe asnjeri nën te”*, siç thoshte T. Ruzvelt, ku respektohen të drejtat e fëmijës dhe ku secili fëmijë i Kosovës ka mundësi të zhvillohet deri te kufijtë e skajshëm të tij, deri aty ku Zoti ka thënë se mund të zhvillohet.

Nga kjo që u tha është plotësisht e qartë se kjo nuk është lehtë. Është një sfidë të cilën duhet ta sfidojmë, nëse mëtojmë të largohem nga cepi i humnerës nëpër të cilin jemi duke ecur.

Në kohën globale dhe postmoderne është jashtëzakonisht vështirë që me një strategji racionale të programohet dhe të bëhet një ndryshim i tillë. Duhet gjetur një balancë ndërmjet asaj që aspirojmë ta bëjmë dhe realizojmë dhe të asaj që në kushtet dhe rrethanat që tani ekzistojnë mund dhe duhet ta bëjmë. Kur e themi këtë duhet të kuptojmë se në ndërlidhjet globale, pavarësisht nga vullneti që kemi, dëshira e madhe që të bëjmë diçka të mirë dhe të madhe, nuk do të jemi në gjendje ta bëjmë këtë, sepse kjo do të varet nga faktorët tjerë jashtë mjedisit – vendit tonë. Dëshirë e jona e flakët që të parandalojmë dhunën, trafikimin e qenieve njerëzore me theks të veçantë të fëmijëve, luftimin e ksenofobisë, nacionalizmit ekstrem, etnocentrizmit, racizmit, homicidit etj. varet se sa këto dukuri luftohen në vendet fqinje dhe në botën globale në përgjithësi.

Zgjidhja e problemeve të këtilla kërkon plotësimin e dy kushteve elementare:

- Të mendojmë globalisht - të shikojmë nga perspektiva e zogut, dhe të veprojmë lokalist, si dhe
- Të bashkëpunojmë, të krijojmë aleanca, konsorciume të fuqishme të të nxëniet dhe të veprimit, ura dhe rrjete të fuqishme sociale për të parandaluar rrezikun e përgjithshëm që na kanoset.

Në këtë ecje, në muajt e fundit ka lëvizje premtuese, të cilat synojnë një qasje të re, proaktive, parandaluese. Në nivel të Kosovës është duke u hartuar një Plan Nacional për Zhvillimin e Kosovës. Paralelisht me këtë plan po punohet në hartimin e Planit Nacional për të Drejtat e Njeriut. MASHT në mënyrë intensive dhe me një qasje shume serioze, është duke punuar në hartimin e Strategjisë për arsimin para-universitar për periudhën 2007–2017. Gjatë muajit nëntor lidhur me këtë Strategji u mbajt një Konferencë Ndërkombëtare shumë e suksesshme.

Këto ditë është hartuar edhe një Draft i Strategjisë Nationale për avancimin e përsheptuar të të drejtave të fëmijës. Më 1 dhe 2 dhjetor në Prishtinë do të mbahet Konferencë rajonale lidhur me këtë Strategji. Të gjitha këto dokumente komplementare dhe tregojnë se Kosova po lëvizë përpara

Shkroi Halim Hyseni

Përshkrimi i aktiviteteve sipas programeve

Edukimi për Të Drejtat e Fëmijës

■ Më 30 tetor të këtij viti, KEC respektivisht programi “Edukimi për të drejtat e fëmijës”, në bashkëpunim me nxënësit e shkollës jopublike “Mileniumi i Tretë”, ka organizuar një “Maskenball” për nder të Natës së Shtrigave.

Kjo festë u mbajt në ambient të shkollës ku nxënësit e kësaj shkolle patën mundësinë të vallëzojnë e të luajnë e po ashtu edhe të zgjedhin fituesit e kësaj feste me maskën më të bukur, maskën më të frikshme dhe kostumin më të bukur.

■ Po ashtu, më 20 Nëntor 2006, për nder të Ditës së Konventës për të Drejtat e Fëmijës, në shkollën “Mileniumi i Tretë”, u mbajt orë letrare. Në këtë orë letrare, në prezencën e prindërve, nxënësit shprehën talentin e tyre përmes eseve dhe krijimeve të tjera artistike si: poezi, pikturë, këngë korale, ekzekutime në instrumente etj. Temat e eseve ishin:



“Si të bëhet njeriu njeri? dhe “Jeta e një vogëlushi varfanjak”.

Esetë u ilustruan me piktura nga nxënësit e kësaj shkolle e po ashtu edhe u shpërblyen.

■ Në kuadër të programit “Të drejtat e fëmijëve” më datën 24.11.2006, në bashkëpunim me Aba Ceeli-n, u zhvillua edhe punëtorja njëditore ku pjesëmarrës ishin: përfaqësuesit e ZRA-ve, drejtorë shkollash, mësime dhënëse të Edukatës qytetare dhe Trajnerët për të Drejtat e Fëmijës. Në punëtori, po ashtu u bë edhe promovimi i tri librave për të Drejtat e fëmijës: 1. Doracak për Komitetin shkollor për të drejtat e fëmijës”; 2. “ Ne jemi lule, ne jemi zogj”, libër ky që përmban poezi të ndryshme nga nxënës të shkollave të ndryshme nga mbarë Kosova. Poezitë janë të shkruara në disa gjuhë; dhe 3. “Ne nuk kemi votë por kemi të drejta...”, një tjetër libër i mbushur me njësi mësimore i cili ndihmon mësime dhënësit e Edukatës Qytetare në zhvillimin e orës mësimore.



■ Përgatitjet për mbajtjen e Konferencës Rajonale për të drejtat e Fëmijës, janë në përfundim e sipër. Konferenca do të mbahet më 01-02 dhjetor 2006 dhe do të ketë rreth 120 pjesëmarrës të ftuar.

Edukimi kundër korrupsionit - EKK

■ Me 14-15 nëntor KEC, përkatësisht programi EKK (Edukimi kundër korrupsionit) ka certifikuar 203 pjesëmarrës që i kanë ndjekur trajnimet e

organizuara nga ky program. Gjithashtu në të njëjtën kohë është bërë edhe monitorimi i tyre nëpër klasa. Me këtë rast EKK ka certifikuar edhe 29 trajnerë.



■ Në kuadër të programit EKK, pas një pune mjaft të madhe, u përgatit dhe u publikua libri “Edukimi kundër korrupsionit”. Ky libër iu është shpërndarë të gjithë pjesëmarrësve me rastin e certifikimit. Në këtë libër janë publikuar edhe mësimet me modele të mësuesve nga Kosova.

■ Në 7 qendrat e Kosovës ka filluar Java e luftës kundër korrupsionit. Gjatë kësaj jave janë organizuar aktivitete të ndryshme: ekspozita të ndryshme nga arti dhe letërsia, tryeza të rrumbullakëta, diskutime të ndryshme, pjesëmarrje në emisione të radiove, hulumtim të opinionit publik e shumë aktivitete tjera. Duhet përmendur së nxënësit me anë të punimeve të tyre nga letërsia dhe arti, kanë shprehur shumë qartë mesazhe kundër korrupsionit. Në fund të aktiviteteve është bërë përzgjedhja e punimeve më të mira ku së paku 10-20 nxënës nga çdo qendër janë shpërblyer për punën e tyre. Gjithashtu është përgatitur edhe posteri me mesazhin: Edukimi, strategjia më efikase për parandalimin e korrupsionit.

Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit – MKLSH

■ Me 4-5 nëntor dhe pastaj 25-26 nëntor janë mbajtur dy seminarët e fundit në kuadër të Programit të MKLSH për 25 grupet që trajnohen në bashkëpunim me MASHT.

Po ashtu është realizuar dhe monitorimi i secilit pjesëmarrës në klasat e tyre për herë të dytë.

■ Në fshatin Irzniq të Deçanit ka përfunduar trajnimi i pestë dhe i gjashtë në kuadër të MKLSH-së. Në vazhden e trajnimeve të tjera me 1 dhe 2 dhjetor do të mbahet trajnimi i fundit për këtë grup.

■ Në shkollën fillore “Hasan Prishtina”, në Prishtinë, me datën 18 dhe 19 nëntor ka përfunduar trajnimi i dytë i 40 mësimitdhënësve, në kuadër të programit MKLSH. Ky trajnim është bërë me vetëfinancim. Në të njëjtën kohë, pra, me datën 18 dhe 19 nëntor edhe në Gjimnazin “Xhevdet Doda” është mbajtur trajnimi i parë në kuadër të MKLSH, i cili u financua nga KEC.

SEE ECN

Më 17-18 nëntor 2006, në Sarajevë është organizuar seminari “Fuqizimi i mësimitdhënësve dhe praktikave të mësimitdhënies dhe të nxënësve në vendet e Evropës Juglindore”. Në këtë seminar ishin të pranishëm edhe përfaqësuesit nga KEC. Gjatë seminarit është shpërndarë libri me hulumtime, në të cilin ka marrë pjesë edhe Kosova. Për më shumë informata drejtohu tek:

<http://www.see-educoop.net/portal/tesee.htm>

Hap pas Hapi

- Më 1-3 nëntor, është mbajtur trajnimi avancues për klasat e para. Në këtë trajnim morën pjesë 25 mësime të cilët.
- Në datat 6-10 nëntor është mbajtur trajnimi avancues për klasat 3-6. Trajnimi kishte rreth 42 pjesëmarrës.
- Më datat 10-12 dhe 18-19 nëntor, programi "Hap pas Hapi" mbajti trajnimin bazik për klasat e para. Këto trajnime u mbajtën në Pejë. Organizimi i këtyre trajnimeve ka shkuar shumë mirë dhe kishte një numër mjaft të madh të pjesëmarrësve.
- Më 17-19 dhe 25-26, në Gjakovë u mbajt trajnimi bazik për klasat e para, ku morën pjesë 30 mësime të cilët e vlerësuar si shumë të rëndësishëm mbajtjen e këtyre trajnimeve në ngritjen e cilësisë së arsimit.
- Për të gjitha trajnimet që janë mbajtur në periudhën kohore nga shtatori deri në nëntor, ka filluar monitorimi i të gjithë pjesëmarrësve. Gjatë këtij monitorimi është vërejtur se njohuritë që pjesëmarrësit i kanë fituar nga trajnimet janë duke i zbatuar gjatë realizimit të orës mësimore.

Strategjitë e reja të mësimeve dhe të nxënies

- Në muajin nëntor ka pasur mjaft shumë aktivitete. Janë mbajtur 3 seminare 2 ditore për 10 grupet të cilat trajnohen në kuadër të këtij programi, të financuar nga Banka Botërore. Gjithashtu ka përfunduar edhe monitorimi për herë të dytë, i cili është realizuar nga trajnerët nëpër klasa.

Përfundon Projekti për Përmirësimin e Pjesëmarrjes në Arsim (PPPA)

Më 30 nëntor përfundoi angazhimi i KEC në Projektin për Përmirësimin e Pjesëmarrjes në Arsim (PPPA), të financuar nga Banka Botërore dhe Agjencioni Kanadez për Zhvillim Ndërkombëtar (CIDA). Roli i KEC në këtë Projekt ishte ofrimi i asistencës teknike Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë në procesin e zbatimit të aktiviteteve të Projektit. Fondacioni "Soros" ishte bashkëfinancues i kësaj komponente.

Në periudhën 2003-2006 nga Projekti përfituan mbi 500 shkolla fillore dhe të mesme, të cilat morën asistencë financiare prej 5,000 – 15,000 EUR në formë të granteve për zbatimin e projekteve shkollore që synonin rritjen e pjesëmarrjes në arsim. Grantet u shpërndanë në 6 raunde, ndërsa disa shkolla përfituan edhe nga dy herë. Projektet ishin të llojllojshme dhe në varësi nga nevojat e shkollës: përmirësime të infrastrukturës, furnizim me pajisje dhe mjete mësimore, organizim transporti, trajnim i mësimeve të cilët, etj. Përveç projekteve shkollore, të gjitha shkollat pjesëmarrëse në PPPA kanë hartuar plane zhvillimore trevjeçare që shërbejnë si orientim për përcaktimin e prioriteteve të shkollës.

I tërë procesi ka ndikuar dukshëm në krijimin e një kulture të planifikimit me pjesëmarrje në nivel shkollor, si dhe në demokratizimin e vendimmarrjes në shkollë dhe në komunë.

Përgatiti: Petrit Tahiri